

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-79/1


Në bazë të Nenit 2 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), Bordi i Drejtorëve të AKP-së përmes procedurës me shkrim sipas nenit 9.5 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me datën 02 Gusht 2016, nxjerr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohen propozim – amendamentet e Ligjit të AKP-së Nr. 04/L-034 (i ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080);
- II. Udhëzohet Menaxhmenti t'i procedoj këto propozim - amadamente tek institucionet përkatëse.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, 02/08/2016



Petrit Gashi

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-79/2


Në bazë të neneve 6.1.14, 9, dhe 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), dhe neneve 18, 19 dhe 28 të Shtojcës së të njëjtit ligj, pas propozimit të Menaxhmentit të Agjencisë për amandamentimin e Rregullorat e procedurës së qiradhënies së aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 26 gusht 2016 nxjerr këtë:


V E N D I M

- I. Aprovohet Rregullorja e Qiradhënies së Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore e amandamentuar sipas versionit final të aprovuar nga Bordi bashkë me Shtojcat e bashkangjitura kësaj Rregulloreje.
- II. Kriteret dhe metodologjia e kësaj Rregulloreje do të zbatohen edhe në rastet e vlerësimit të qirave të ndërlidhura me lirimin e aseteve të uzurpuara si dhe në rastet tjera kur themelohen komisione për vlerësimin/përcaktimin e vlerës së qirave.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 26 / 08 / 2016




Petrit Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-79/3


Në bazë të neneve 6.1.14, 15.1 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080) nenit 18.1.3, 18.1.5 dhe 28.1 të Shtojcës së të njëjtit Ligj, si dhe nenin 3.7.1.iv të Udhëzuesit të Likuidimit, Rregullores së Qiradhënies së aseteve të NSH-ve, pas shqyrtimit të kërkesës së palës dhe propozimit të Autotitetit të Likuidimit me pëlqim të Menaxhmentit të Agjencisë, Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 26 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet dhënia me qira përmes metodës së qiradhënies direkte e pronës prej 4,500 m² të Ndërmarrjes Shoqërore PRN053 NSh Miniera dhe industria e magnezit - MIM Goleshi (në likuidim), midis PRN053 NSh Miniera dhe industria e magnezit - MIM Goleshi (në likuidim) dhe Ndërmarrja e re Ferronikeli Complex L.L.C. në vlerën e qirasë vjetore prej 70 EUR në vit për qiranë e pronës si dhe kompensimin shtesë për shfrytëzimin e xehe prej 0.40 EUR për ton xehe të ekstraktuar, për një periudhë deri në 12 muaj;
- II. Aprovohet raporti i Komisionit të brendshëm të AKP-së për vlerësimin e gjendjes dhe vlerën e tanishme të kësaj ngastre si dhe për vlerësimin e qirasë për shfrytëzimin e ngastrës kadastrale si dhe kompensimin shtesë për materialin nikel të ekstraktuar nën ngastrën e sipërpërmendur;
- III. Obligohet AL e NSH MIM Golesh (në likuidim) që të lidh kontratën vetëm pasi që të jenë të plotësuara të gjitha kushtet e përcaktuara në propozimin e AL-së dhe Komisionit vlerësues, për garancionin bankar dhe afatet kohore të përcaktuara.
- IV. Pas përfundimit të punëve kontraktuale themelohet Komision i AKP-së për të vlerësuar gjendjen e ngastrës pas periudhës së shfrytëzimit duke përfshirë dhe konstatimin për gjendjen e asetit të kthyer.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, 26/08/2016




Petrit Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit